



Public Dialogue

on the Sustainable Use of
Energy in South-East Europe

ENERGJI EFIÇENTE ENERGJI E SIGURTË




Akademia e Studimeve Politike Kotroni Center, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 2272173; +355 4 4504788; Fax: +355 4 2272173 E-mail: info@asp.al; Web: www.asp.al

Efienca e energjisë

Përdorimi eficient i energjisë, ose ndryshe, “Efienca Energjie”, cilësohet procesi i konsumit të energjisë për të plotësuar nevojat tona jetësore duke arritur të njëjtat rezultate, por duke përdorur më pak energji. Teprica e energjisë në këtë rast konsiderohet si energji e kursyer. Masat kryesore për të përmirësuar efiençën e energjisë në një ndërtesë janë:

- Termoizolimi i ndërtesës
- Instalimi i dyerve dhe dritareve dopio xham
- Ngrohje qendrore
- Ndiriçim efient
- Pajisje elektroshtëpiake efiente
- Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë
- Kontroll dhe mirëmenaxhim i energjisë

Përdorimi i energjisë në banesa



Ndryshe nga vendet e rajonit, ngrohja e ndërtesave në vendin tonë sigurohet në shumicën e rasteve nëpërmjet energjisë elektrike. Me rritjen e mirëqenies sociale dhe shtimit të pajisjeve elektrike në banesa, konsumi i energjisë ka

patur një rritje prej 8 përqind çdo vit dhe pjesa më e madhe e kësaj energjie konsumohet për ngrohjen e banesave. Vendi ynë e prodhon energjinë elektrike nga burime të rinovueshme (burimet ujore), por në rast thatësie të zgjatur i gjithë sistemi i prodhimit mund të bjerë në kolaps. Si rrjedhojë, është i nevojshëm diversifikimi i mënyrave të prodhimit të energjisë duke shtuar burime të tjera të rinovueshme, por njëkohësisht edhe kursimi i konsumit.



Përdorim joeficient i energjisë

Përse nevojitet efienca e energjisë :


Në planin personal, kursimi i energjisë, ndikon në reduktimin e faturave financiare, që duhet të paguajnë konsumatorët dhe institucionet publike. Në një plan më të gjerë, reduktimi i konsumit të energjisë është një mënyrë për të reduktuar emetimet e gazrave me efekt serë në atmosferë duke mbrojtur mjedisin. Kursimi energjitik përbën një nga kushtet themelore për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe gjithashtu mbetet një prej politikave të detyrueshme për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian.

Termoizolimi i ndërtesës

Izolimi termik i ndërtesës është një nga mënyrat më efikase për të siguruar efikasitetin e energjisë. Nëpërmjet përdorimit të materialeve izoluese në mure, çatinë/tarracën apo dyshemenë e shtëpisë sigurohet një kontroll më i mirë i humbjes së nxehtësisë në dimër dhe freskisë në verë. Si rrjedhojë ka një konsum më të ulët të energjisë. Kosto e izolimit termik përbën vetëm 1.5 - 2 përqind të koston për ndërtimin e një banese, ndërkohë që kursimi në konsumin e energjisë për ngrohje falë këtij investimi fillestar arrin rreth 35-50 përqind të energjisë së përdorur për ngrohje/ftohje. Termoizolimi ndikon gjithashtu edhe në rritjen e komfortit të jetesës si dhe në jetëgjatësinë e ndërtesës.




Humbje e energjise per mungese të izolimit



Një tjetër element mjaft i rëndësishëm i izolimit të ndërtesave janë dyert dhe dritaret. Humbjet nga dritaret arrijnë deri në 50 përqind të nxehtësisë së nevojshme për ngrohjen e ndërtesës (duke përllogaritur humbjet nga transmetimi si dhe ventilimi). Ndërrimi i dritareve të vjetra prej druri me dritare duralumini apo ato plastike dhe me dopio xham, redukton humbjet e nxehtësisë





Kursen deri
në **35 -50 %**
të energjisë
për ngrohje




2-3 herë. Një element i rëndësishëm për kontrollin e humbjeve të nxehtësisë nga dritaret është izolimi i duhur i pjesës lidhëse të tyre me muret (kasës së dritares). Riparimi dhe izolimi i këtyre lidhjeve është i lehtë dhe pa ndonjë kosto të lartë financiare.




Ngrohja qendrore

Deri në 60 përqind e energjisë së konsumuar në banesa dhe ambiente publike harxhohet për ngrohjen e tyre. Në pjesën më të madhe të ndërtesave ngrohja sigurohet vetëm në një dhomë apo në pjesë të caktuara të saj, duke mos krijuar komfortin e duhur të jetesës. Përdorimi i sistemeve të ngrohjes qendrore, sidomos në ndërtesat publike, ndikon drejtpërsëdrejti në uljen e konsumit të energjisë, por njëkohësisht rrit cilësinë e jetesës në to. Shembulli më i mirë i kësaj praktike janë kopshtet dhe shkollat, në të cilat përdoren masat e termoizolimit dhe sisteme të ngrohjes qendrore, duke siguruar një ambient të shëndetshëm qëndrimi për fëmijët.





Valvula termostatike



Edhe në sistemet qendrore të ngrohjes është e nevojshme që të merren disa masa kursimi. Me e rëndësishmja prej tyre është instalimi i valvulave termostatike në radiatorët e ngrohjes, nëpërmjet të cilave kursehet deri në 20 përqind e energjisë së përdorur. Gjithashtu rekomandohet që temperaturat e programimit të kaldajës të jenë sa më të ekuilibruara për të siguruar jo vetëm konsum më të ulët energjie, por edhe rendiment të pajisjes.

Ndriçimi eficient

Edhe pse në sasi më të vogla, ndriçimi përbën një konsum të vazhdueshëm të energjisë. Për të reduktuar këtë konsum energjitik, rekomandohet që të gjitha llambat tradicionale inkandeshente, të zëvendësohen me llamba fluoreshente apo ndryshe eficiente. Këto llamba kanë një çmim pak më të lartë, duke filluar nga 350 - 400 lekë, por jetojnë 10 herë më gjatë se ndriçuesit tradicionalë. Gjithashtu, ato kursejnë deri në 80 përqind të energjisë së përdorur për ndriçim.

Kur vjen fjala për ndriçimin publik të rrugëve dhe objekteve publike, kursimi nga përdorimi i llambave fluoreshente është edhe më i madh. Vetëm në qytetin e Tiranës përllogariten se ndizen çdo mbrëmje rreth 14 mijë llamba të modelit të vjetër dhe energjia e konsumuar prej tyre në një vit arrin rreth 6.8 milionë kwh. Nëse do të ndryshohen këto llamba me ato eficiente, kursimi në faturën e energjisë elektrike do të shlyejë brenda disa muajve investimin

e kryer. Paratë e kursyera nëpërmjet këtij procesi, mund të përdoren nga bashkia për investime të tjera publike në qytet.



Llambat ekonomike jetojnë 10 herë më gjatë e kursejnë deri në 80 % të energjisë





- Përdorimi i pajisjeve elektro-shtëpiake efçente ndikon drejt-përsëdrejti në kursimin e konsumit energjitik.
- Në çdo pajisje të re elektro-shtëpiake ndodhet një çertifikatë efçence, e cila tregon shkallën e konsumit energjitik të saj.
- Përpiquni të blini pajisje që i për-kasin klasës energjike A, A+, A++.



Panelet diellore

Shqipëria ka një mesatare prej 240 - 260 ditësh me diell përgjatë vitit dhe si rrjedhojë përdorimi i energjisë diellore është mjaft i volitshëm. Panelet diellore ndahen në dy llojesh: ato fotovoltaike, që përdoren për prodhimin e energjisë elektrike, dhe kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit, të cilët shfrytëzojnë nxehtësinë diellore për ngrohjen e ujit sanitar në ndërtesa.

Panelet fotovoltaike, janë jo vetëm një mënyrë për të reduktuar faturën e energjisë elektrike, por njëkohësisht sigurojnë furnizim me energji në rast të mungesës së saj në zonat malore apo të izoluar.



Përdorimi më i gjerë i paneleve diellore në vendin tonë është ai për ngrohjen e ujit, pra kolektorëve diellorë. Ngrohja e ujit që përdoret për dushin dhe larjen e enëve, përbën deri në 25 përqind të energjisë së përdorur në





Çati e mbuluar me panele fotovoltaike

banesa në vendin tonë.
Falë instalimit të një
paneli diellor për ujin e
ngrohtë, kursimi energ-
jitik është i konsiderue-
shëm, deri në 60 përqind
të energjisë së përdorur
për këtë qëllim.



Përdorimi i panelit
diellor për ujë të nxehtë kursen
më shumë se 60 % të energjisë
së përdorur për këtë qëllim.



*Panel për
ngrohjen
e ujit*



Efienca nga biomasa


Biomasa (druri i zjarrit, prodhimet bimore apo mbeturi-
nat organike) mbetet një nga mënyrat më ekonomike
për të siguruar energjinë, sidomos për fermat bujqësore
apo ndërtesat në zona rurale. Drutë e zjarrit përbëjnë
biomasën me përdorim më të gjerë në vendin tonë, por
është i këshillueshëm përdorimi i sobave efiente, të
cilat krijojnë një ngrohtësi më të madhe me një sasi më
të vogël drusore.



Kursimi nga përdorimi i sobave
efiente me dru zjarri arrin deri
në 30 % në krahasim me sobat
tradicionale



Një tjetër risi në
ngrohjen e serave
bujqësore është in-
stalimi i kaldajave,
të cilat përdorin
si lëndë djegëse
bërsitë e ullirit.
Këto kaldaja nuk
kërkojnë investime
të mëdha, ndërkohë
që kursimi nga
përdorimi i tyre e
shlyen shumë shpe-
jt koston fillestare.






Típ kaldaje që
djeg bërsi ulliri për
ngrohjen e serës



Shembull i një investimi në biomasë

Kaldaja me bërsi ulliri e instaluar pranë fermës së Z. Hajdar Kuçi në Marikaj, pranë Durrësit, siguron ngrohjen e një sere bujqësore me sipërfaqe 500 metra katrorë. Kostoja e sigurimit të bërsive të ullirit është 8 herë më e ulët se kosto e naftës që nevojitej më parë për ngrohjen e serës. Stimulimi i kultivimit të ullirit në vitet e fundit, pritet që ta bëjë edhe më të lehtë sigurimin e bërsive si lëndë djegëse për këto kaldaja efçente.



Vlera e investimit fillestar
në termoizolim është e
barabartë me kursimin
e 8 viteve të para



Kreditimi bankar

Investimet për termoizolim dhe instalimin e paneleve diellore apo blerjen e pajisjeve ngrohëse dhe elektroshtëpiake eficiente, mund të kreditohen nga sektori bankar shqiptar me një afat të gjatë shlyerje dhe me interesa më të lehta se kreditë normale. Bankat që ofrojnë këto kredi janë bankat “ProCredit”, “Credins”, “Societe Generale”, “BKT” si dhe “Fondi Besa” dhe ai “NOA”. Për t’u njohur më tej me kushtet dhe detajet e tjera të aplikimit për një kredi mbi eficientësinë e energjisë mund të drejtoheni pranë degëve të këtyre bankave.





Shembull i një kreditimi

Investimi fillestar për termoizolimim e një banese me sipërfaqe 150 metra katrorë duke përdorur shtresat izoluese në mure dhe çatinë e saj mund të kushtojë përafërsisht 450.000 lekë. Falë këtij investimi, banesa do të kursejë 35 përqind të energjisë për ngrohje, apo ndryshe rreth 56.000 lekë nga fatura vjetore e energjisë elektrike. Pra investimi në termoizolim mund të “shlyhet” nga kursimi ekonomik brenda 8 viteve të para të ndërtesës. Falë termoizolimit, banesa do të jetë më e ngrohtë dhe si rrjedhojë niveli i jetesës më i lartë, ndërkohë që amortizimi i ndërtimit nga faktorët natyrorë më i ulët.



Public Dialogue
on the Sustainable Use of
Energy in South-East Europe

Ky botim është përgatitur në kuadër të programit "Dialogu Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë", me mbështetjen financiare të "Fondeve të hapura rajonale për Evropën Juglindore për Eficiencën e Energjisë" të Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman (GIZ). Në Shqipëri, inisiativa zbatohet nga Akademia e Studimeve Politike dhe synon të krijojë një ndërgjegjësim më të madh dhe politika efektive ndaj energjisë në vendin tonë

ENERGJI EFIÇENTE ENERGJI E SIGURTË

Për më tepër informacione mbi
programin mund të na vizitoni në:
www.publicdialogue-energy.com
dhe www.asp.al



© 2013 Akademia e Studimeve Politike.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Konsulenca teknike: Ing. Teuta Thimjo
Foto: Light Studio Agency
Layout: WebPhotoPro



Akademia e Studimeve Politike Kotroni Center, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 2272173; +355 4 4504788; Fax: +355 4 2272173 E-mail: info@asp.al; Web: www.asp.al